

BAZA PËR KONKLUSIONE

“PËR

DISA NDRYSHIME NË SKK 9 KOMBINIMI I BIZNESEVE DHE KONSOLIDIMI”

	BAZA E KONKLUSIONEVE
	KONSOLIDIMI
	Njësitë e kontrolluara – Kërkesat për paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara
BK1	Paragrafi 34A shtohet i ri për të reflektuar Art 27.1 të Direktivës e cila kërkon që kur një njësi ekonomike e përfshirë në konsolidim ka një interes pjesëmarrës në një njësi tjetër ekonomike, informacioni financiar për këtë të fundit të paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara si zë më vete me një përshkrim të përshtatshëm;
BK2	Paragrafi 35 ndryshon për të reflektuar Art 23.3 (a,b) të Direktivës ku ku parashikohen rastet kur njësia ekonomike mëmë nuk paraqet pasqyra financiare të konsoliduara;
BK3	Paragrafi 41 (ekzistues) hiqet sepse bie ndesh me kërkesën e Direktivës në Art 23.9 gërma c(i). Kjo është një kërkesë që bie ndesh me sa kërkohet në SNRF për NjVM por në kuadër të transpozimit prevalon në raport me kërkesën ekzistuese;
BK4	- Paragrafi 41A1 shtohet i ri për të reflektuar Art 23.9 (a,c) ku parashikohen rastet kur nuk është e nevojshme që një njësi ekonomike mëmë të konsolidojë një njësi ekonomike bijë në pasqyrat e saj të konsoliduara;
BK5	- Paragrafi 41A2 shtohet i ri për të reflektuar Art 23.10 (b) në të cilin parashikohen rastet kur një njësi mëmë është e përjashtuar nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara;
	Data të njëjta raportimi
BK6	Paragrafi 48A shtohet i ri për të reflektuar kërkesat e Art 24.8 (a, b dhe c) i cili lejon ose kërkon që pasqyrat financiare të konsoliduara të përpilohen në një datë tjetër, të ndryshme nga sa përcaktohet në paragrafin 48 të këtij Standardi;
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	Për të gjitha kombinimet e bizneseve
BK7	Paragrafi 60A shtohet i ri për të reflektuar Art 24.3 (d) i cili kërkon që në shënimet e pasqyrave financiare të shpjegohen metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës së emrit të mirë në kombinimin e biznesit si dhe çdo ndryshim i rëndësishëm i vlerës së tij në raport me vitin paraardhës financiar;
	Njësitë e kontrolluara – Dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të konsoliduara
BK8	Paragrafi 61A1 shtohet i ri për të reflektuar Art 28.2 të Direktivës i cili kërkon që në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës të jepet informacion: (a) në lidhje me të dhëna për njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim si emri, selia dhe kapitali i investuar tek to nga mëma (b) emrat dhe selinë e regjistruar të njësive ekonomike ku, njësitë e përfshira në konsolidim tek mëma, kanë interesa pjesëmarrëse (c) emrat dhe selinë e regjistruar të

	njësive ekonomike të konsoliduara në mënyrë proporcionale (d) në lidhje me secilën prej njësive ekonomike ku mëma mban një interes në pjesëmarrje;
BK9	Paragrafi 61A2 shtohet i ri për të reflektuar Art 23.4 (c, d) i cili kërkon të jepen nga njësia ekonomike mëmë disa shënime shpjeguese të caktuara për rastet kur kjo mëmë është e përjashtuar nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara.
	DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE
BK10	Paragrafi 64 përcakton datën efektive të ndryshimeve që pëson SKK 9 i përmirësuar. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2019 dhe zbatohen në mënyrë prospektive.